

Pushteti vendor 2.6 miliardë lekë më shumë në buxhetin e shtetit

Taksat e pushtetit vendor, të ardhurat e të cilave shkojnë në buxhetin e shtetit, janë ato mbi pasurinë, tatimi mbi biznesin e vogël dhe taksa lokale

Reformat e ndërmarra apo rritja e disa tarifave nga bashkitë kanë dhënë efektet e pritshme, duke bërë që pushteti vendor të ketë një performancë pozitive. Tashmë ecuria e shumë viteve kur njësitë e qeverisjes vendore "vegjetonin" vetëm më fondet e buxhetit të shtetit, duket se ka mbetur pas. Referuar të dhënave të treguesve fiskalë të Ministrisë së Financave, rezultojnë se gjatë 5-mujorit të këtij viti janë mbledhur rreth 9.3 miliardë lekë ose 2.6 miliardë lekë më tepër sesa e njëjta periudhë e një viti më parë. Sipas statistikave zyrtare të Financave, në 5 mujorin e parë të vitit 2016, në buxhetin e shtetit janë arkëtuar nga pushteti vendor 6.7 miliardë lekë.

Aktualisht, taksat e pushtetit vendor, të ardhurat e të cilave shkojnë në buxhetin e shtetit, janë ato mbi pasurinë, tatimi mbi biznesin e vogël dhe taksa lokale. Por referuar të dhënave, dy janë analizat që mund të bëhen, ose parashikimi është më i ulët se kapaciteti, ose pushtetarët vendorë kanë rritur performancën. Por në gjithë këto vite njësitë e qeverisjes vendore nuk kanë administruar në mënyrë efikase, çka është reflektuar në treguesit e të ardhurave. Ndërkohë reforma për ndarjen e re administrative të vendit, që tashmë ka hyrë në fuqi në pjesën e dytë të vitit 2015, ka sjellë ndryshime edhe në buxhetet e planifikuara të njësisve vendore.

Dixhitalizohen vërtetimet, së shpejti online, në çdo kohë dhe pa asnjë kosto

Me qëllim përmirësimin dhe modernizimin e shërbimeve si dhe rritjen e performancës së institucionit së shpejti Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve njofton se do të ofrojë në platformën online e-albania 9 shërbime shumë të rëndësishme për bizneset dhe qytetarët. Së shpejti sipërmarrësit dhe individët do të mund të bëjnë kërkesë dhe shkarkojnë on line vërtetimet si më poshtë:

- Vërtetim për pagesën e detyrimeve
- Vërtetim xhiro për 3 vitet e fundit
- Vërtetim për përgjegjësitë tatimore
- Vërtetim statusi (aktiv, pasiv përfshirë datën)
- Vërtetim për regjistrim të investitorit
- Vërtetim për pagesën e kontributeve nga subjekti
- Vërtetim për posedim mjeti
- Vërtetim për individ të paregjistruar
- Vërtetim për pagesën e kontributeve për individin
- Për një pjesë të këtyre shërbimeve përgjigjja do merret




në kohë reale dhe vërtetimi i ofruar në mënyrë elektronike do ketë firmë dhe vulë dixhitale. Qytetari ose tatimpaguesi do të logohet në portalin e-Albania me kredencialet e tij (emër përdoruesi dhe fjalëkalim) dhe do të zgjedhë shërbimin që i nevojitet. Implementimi i këtij projekti ka rëndësi dhe ndeshmëri të lartë pasi ndihmon si institucionin ashtu edhe qytetarët në minimizimin e kohës së ofrimit dhe marrjes së shërbimeve. DPT është e angazhuar maksimalisht në lehtësimin e procedurave për të ofruar në çdo kohë dhe me sa më pak kosto shërbim cilësor për çdo tatimpagues.

Rritet konsumi i karburanteve, mbi 18 mijë ton më shumë se 2016

Konsumi i karburanteve gjatë muajve të parë të këtij viti është rritur. Sipas statistikave zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, për këtë periudhë 5 mujore janë hedhur për konsum 231 908 ton karburant, ndërkohë që në të njëjtën periudhë të viti më parë ishin 195 677 ton. Pra sipas këtyre të dhënave rezultojnë se gjatë këtij viti janë hedhur për konsum mbi 18 231 ton karburante. Duke qenë se ky vit përkoji me zgjedhjet parlamentare, mund të analizojmë edhe faktin se fushata elektorale ka ndikuar në konsum. Por edhe rritja e nivelit të investimeve publike gjatë kësaj periudhe mund të komentohet si një mundësi më e madhe konsumi karburanti.

Referuar të dhënave nga Doganat nuk ka një ndarje se sa është sasia e importuar e karburanteve dhe sa është prodhim vendas. Por, po të analizojnë rritjen për importin e karburanteve se çfarë mund të ketë ndikuar te ulja e çmimit të naftës në tregjet ndërkombëtare. Kjo mundësi mund të jetë shfrytëzuar nga importuesit për të rritur depozitat në vend për të përfituar nga çmimi i ulët në blerje. Megjithatë kjo është një shenjë e mirë për ekonominë vendase, pasi presupozohet se është rritur konsumi, por edhe për buxhetin e shtetit pasi të ardhurat nga zhdoganimi i mallrave me akcizë zënë një vend të rëndësishëm në të ardhurat e përgjithshme të administratës doganore.



BASHKIA LIBRAZH D

THIRRJE PËR TENDER

Bashkia Librazhd në kuadër të projektit "Rikonstruksioni dhe Rehabilitimi i Qendrës Kulturore të Fëmijëve ne Librazhd" financuar nga programi IADSA, shpall tenderin për punimet me objektin "Rikonstruksion të Qendrës Kulturore të Fëmijëve" në qytetin e Librazhdit me fond limit **43,460,494 lekë**. Thirrja do të jetë e hapur nga data 03/07/2017 deri në 02 /08/2017.

Disa nga Kriteret e kualifikimit:

- Kompania nuk është në proces falimentimi;
- Nuk është dënua për shkelje penale, ose me vendim gjykatë të formës së prerë që lidhet me aktivitetin profesional;
- Ka plotësuar detyrimet fiskale, ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore;
- Të disponojë licencat e nevojshme për zbatimin e kontratës bazuar në formatin e miratuar me VKM nr. 42 datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi" i ndryshuar;
- Të tregojë nëpërmjet dokumenteve përkatës (kopje kontrate, akt kolaudimi, etj) që është në gjendje të zbatoj projektin dhe të ofrojë të gjitha njësitë e kërkuara në specifikimet teknike.

Dokumentet e prokurimit bashkë me kriteret e tjera specifike të kualifikimit mund të tërhiqen pranë zyrës së sektorit juridik në Bashkinë Librazhd me adresë: Sheshi "Gjorg Golemi", Librazhd, Shqipëri, çdo ditë nga ora 10-14, nga personi i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Oferta bashkë me dokumentacionin përkatës të paraqitet pranë Bashkisë Librazhd, në zyrën e sektorit juridik deri në datën 2 Gusht 2017 ora 13.00, në zarf të mbyllur dhe të vulosur.

Adresa : Sheshi Gjorg Golemi, Librazhd

www.bashkialibrazhd.gov.al, email: info@bashkialibrazhd.gov.al